

Gezim Novoberdaliu, informator sigurimi:

## – Ne kemi aftësitë e nevojshme dhe jemi të lumtur t'i ndihmojmë anëtarët tanë

**Në vitin 2007, mora detyrën time të parë si ndihmës në vend pune. Menjëher pas kësaj, u bëra edhe agjent mbrojtës dhe informator sigurimesh. Unë formova një klub sindikate në vendin tim të punës dhe u zgjodha kryetar. Kjo ishte brenda Sindikatës së Punëtorëve të Ushqimit.**

Si përfaqësues i zgjedhur, kam ndjekur kurse të ndryshme trajnimi dhe këto më dhanë një njohuri të madhe në përgjithësi, por veqanërisht në fushën e mjedisit të punës dhe sigurimeve. Unë jam pak më shumë i apasionuar pas këtyre fushave.

Ndërmjet viteve 2007 dhe 2013 pata mundësinë të ndihmoj shumë anëtarë duke përmirësuar kushtet e tyre të punës në punë. Por edhe për të rikthyer paratë e harruara nga sigurimet kontraktuale dhe anëtarë që u takonin, por nuk i dinin.

### **Nga Livs në IF Metall**

Kur mora një punë në Benders Sverige AB në vitin 2015, u transferova në IF Metall. Fillimisht punova në Kinnevedum, por në vitin 2018 u transferova në fabrikën në Edsvära. Në vitin 2019, unë u zgjodha përsëri si administrues i besuar dhe u caktova si oficer kryesor i mbrojtjes, informator i sigurimit dhe anëtar i bordit të klubit. Gjithashtu këtu në Benders gjeta mjaft shumë para të harruara që bashkë-anëtarët kishin humbur atë që kishin të drejtë nga sigurime të ndryshme.

Rasti më i fundit që pata ishte me një

kolege të quajtur Eva Löfqvist, e cila ka punuar për 15 vjet në Bendes. Ajo ka pësuar dëmtime dhe operacion në të dyja duart. Kjo ka bërë që ajo është larguar nga puna për një kohë të gjatë me pushim mjekësor.

### **Merrni ndihmën e informatorëve të IF Metall drejtpërdrejt në vend që të kontaktoni kompani të ndryshme dhe të humbni shumë para krejtësisht panevojshëm**

Vitin e kaluar (2021) kam punuar me të në repartin e aksesorëve dhe ajo nuk ndihej mirë. I rekomandova që të kërkonte trajtim dhe ajo e bëri këtë menjëherë. Ajo u diagnostikua me Diabet. I mbledha të gjitha dokumentet nga viti 2015-2021 kur ajo ishte në pushim mjekësor dhe i dërgova në AFA dhe Folksam.

### **Nuk e dinin për të drejtën e kompensimit**

Eva kishte kontraktuar sigurimin e sëmundjes dhe pajtueshmërisë nga Folksam, i cili është një sigurim shtesë që mund ta bëni si anëtarë. Ajo nuk e dinte se kishte të drejtë kompensimi nga ky sigurim. Pas disa ditësh, ajo mori konfirmimin nga Folksam se do të merrte 4000

SEK për pushim mjekësor dhe gjithashtu 50,000 SEK për diagnozën e saj të diabetit. Eva ishte me fat që mori kompensimin për diagnozën e saj, sepse prej 1 janarit të këtij viti (2022), diabeti u hoq si diagnozë në Folksam. Mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme që të theksohet puna e informatorëve të sigurimeve dhe gjithashtu që anëtarët të ndërgjegjësohen për ndihmën që mund të marrin nga ne qdo ditë në vendin e punës. Ne ekzistojmë dhe ofrojmë ndihmën tonë plotësisht pa pagesë si përfitim anëtarësie.

### **I lumtur për të ndihmuar pa kompensim**

Fatkeqësisht, ka kompani që përpiqen të fitojnë para duke i ndihmuar njerëzit të marrin paratë që u takojnë nga kompani të ndryshme sigurimesh. Insurello, për shembull, është një kompani që i ndihmon njerëzit të nxjerrin para nga Folkam dhe Afa. Për punën e tyre ju ngarkojnë 25 për qind të shumës që merrni nga kompanitë e sigurimit. Këto janë krejt budallaqë dhe krejtësisht të panevojshme për t'u paguar pasi anëtarët tanë mund ta marrin këtë ndihmë plotësisht falas nga ne informatorët e sigurimeve qdo ditë.

Ne kemi aftësitë e nevojshme dhe jemi të lumtur t'i ndihmojmë anëtarët tanë me këtë shërbim.

Me respekt Gezim Novoberdaliu  
Informator i Sigurimeve në Benders në Edsvära



Benders

Benders

MONTERINGSANVISNING

Illustration of a roof structure with tiles and a cross-section of a roof assembly.